



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12167 Prot

Lezhë, më 29/06 /2022

VENDIM

Nr. 66, Datë 28. 06. 2022

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT TË BASHKISË LEZHË ME KOMUNEN E GJAKOVËS DHE CREATIVE BUSINESS SOLUTIONS (CBS) PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “NDËRLIDHJA E TURIZMIT PËRMES TRASHËGIMISË KULTURORE DHE ZGJIDHJEVE INTELIGJENTE NË LEZHË DHE GJAKOVË”.

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Thirrjen e tretë për aplikime nga Komisioni Evropian në “Programin ndërkufitar Shqipëri – Kosovë sipas Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)”, aplikimin e projektit me reference aplikimi IPA/2021/171146-2/8, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 7, datë 01.02.2022, me nr.1481 Prot., Datë 04.02.2022 për miratimin e projektit “Ndërlidhja e turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”, Kontratën e Grantit 2022/432-185 ndërmjet Komisionit Evropian dhe Bashkisë Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e draft Marrëveshjes së Partneritetit të Bashkisë Lezhë me Komunën e Gjakovës dhe Creative Business Solutions (CBS) për zbatimin e projektit “Ndërlidhja e turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 4511/14 Prot.

Lezhë, më 05.07.2022

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.66, datë 28.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e marrëveshjes së partneritetit të bashkisë Lezhë me komunën e Gjakovës dhe Creative Business Solutions(CBS) për zbatimin e projektit "Ndërlidhja e turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë",

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

